



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 128
Prishtinë, më 16 shtator 2010

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 16 SHTATOR 2010**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 6 shtator 2010,
2. Interpelanca e Kryeministrit të Kosovës, zotit Hashim Thaçi, sipas kërkesës së deputetit Emrush Xhemajli, mbështetur edhe nga disa deputetë të tjerë,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për persona të zhdukur,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për financimin e subjekteve politike,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për konfliktet administrative.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 6 shtator 2010

Procesverbali i mbledhjes plenare, të mbajtur më 6 shtator 2010, u miratua pa vërejtje.

2. Interpelanca e Kryeministrit të Kosovës, zotit Hashim Thaçi, sipas kërkesës së deputetit Emrush Xhemajli, mbështetur edhe nga disa deputetë të tjerë

Kryesuesi i njoftoi deputetët për mocionin e deputetit Emrush Xhemajli, të mbështetur edhe nga disa deputetë të tjerë, për ta ftuar kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçi në interpelancë lidhur me prishjen dhe rinegociimin e Marrëveshjes mbi sigurimet shoqërore ndërmjet Zvicrës dhe Kosovës.

Ai ftoi propozuesin e mocionit për interpelancë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë atë.

Deputeti **Emrush Xhemajli** tha se duke iu përgjigjur shqetësimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët gjenden me punë në Zvicër, dhe meqenëse çështja për të cilën po diskutojmë ndërlidhet me disa ministri, siç janë: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Integrimeve Evropiane, ne grupi i deputetëve nënshkruar kemi parashtruar kërkesë për interpelancë Kryeministrit Hashim Thaçi lidhur me prishjen dhe me rinegociimin e Marrëveshjes mbi sigurimet shoqërore ndërmjet Zvicrës dhe Kosovës.

Në vazhdim, tha se Enti Federal i Sigurimeve Shoqërore të shtetit zviceran njoftoi se nga 1 prilli 2010 nuk do të vazhdohet Marrëveshja mbi sigurimet shoqërore ndërmjet Zvicrës dhe ish- Jugosllavisë në raport me Kosovën, me arsyetimin se Marrëveshja në fjalë nuk i përgjigjet legjislacionit aktual të dy shteteve.

Këtë vendim të Qeverisë së Zvicrës ai e vlerësoi si jodiskriminues, por me pasoja për rreth 170 mijë qytetarët e Kosovës me punë në Zvicër, të cilëve u takon pensioni i pleqërisë, pensioni invalidor, kompensimi nga fatkeqësitë dhe sigurimet shëndetësore. Po ashtu, me këtë vendim të Qeverisë së Zvicrës, u hiqet e drejta në marrjen e shtesave edhe fëmijëve të punëtorëve tanë të cilët kanë vendbanimin në Kosovë, tha ai.

Më tutje, tha se qytetarët e Republikës së Kosovës nuk duhet të bien pre e agjencive të ndryshme private për tërheqjen e kontributeve nga shteti zviceran.

Në fund, ai ftoi deputetët e Kuvendit që të votojnë rekomandimet e propozuara dhe ato që mund të jenë si rezultat i diskutimeve në Kuvend.

Kryeministri **Hashim Thaçi** tha se mbrojtjen shëndetësore Qeveria e Republikës së Kosovës e ka përherë ndër prioritetet e veta. Çështja e rregullimit të sigurimeve shoqërore për qytetarët e Kosovës me punë në Zvicër deri më tani ka qenë e rregulluar me Marrëveshjen mbi sigurimet shoqërore ndërmjet Zvicrës dhe ish RSFJ-së, të vitit 1962.

Në vazhdim, tha se njëra nga arsyt kryesore për ndërprerjen e kësaj Marrëveshje për qytetarët e Republikës së Kosovës ka qenë se legjislacioni në Kosovë duhet të jetë në përputhje me realitetin e ri të krijuar dhe me atë të Zvicrës.

Nga momenti i njoftimit për ndërprerjen e kësaj Marrëveshjeje, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë hapat për rregullimin e kësaj problematike, kështu që nga ajo kohë ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, por edhe unë personalisht kemi pasur takime me ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, tha kryeministri. Ai përmendi disa shembuj të këtyre aktiviteteve, siç është ai për formimin e grupit teknik profesional për negociimin e Marrëveshjes së re, pastaj notën verbale të MPJ-së të Kosovës dërguar ambasadës së Zvicrës, me 6 maj 2010, takimin e grupit punues të Qeverisë së Kosovës me autoritetet kompetente zvicerane më 1 - 2 shtator 2010, në Bernë etj. Kryeministri Thaçi gjithashtu

konstatoi se ministritë përkatëse janë duke punuar vazhdimisht me organet kompetente zvicerane për përmbylljen sa më të shpejtë të kësaj marrëveshjeje.

Nga ana tjetër, janë marrë masa konkrete për hartimin e Projektligjit për sigurimet pensionale, si dhe të Projektligjit për sigurimet shëndetësore, të cilat pritet që në muajin nëntor të miratohen në Qeveri, në mënyrë që më pas menjëherë të dërgohen në Kuvend, tha ai.

Në fund, kryeministri u zotua se Qeveria do të vazhdojë ta mbikëqyr këtë çështje me vëmendjen dhe përkushtimin më të madh.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramadan Avdiu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Nurisha Hula, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Rita Hajzeraj, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Branislav Grbić, si dhe deputetët: Driton Tali, Naim Rustemi, Flora Brovina, Ahmet Isufi, Riza Smaka, Zylfije Hundozi, Kaqusha Jashari, Vezira Emrush, Gani Buçinca, Berim Ramosaj, Teuta Hadri, Hajdin Abazi, Eqrem Kryeziu, Qamile Morina, Ibrahim Gashi, Arsim Bajrami, Sabri Hamiti, kryeministri Hashim Thaçi, zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, që janë dhënë në transkript.

Në fund, deputeti **Emrush Xhemajli**, në emër të propozuesit të kërkesës për interpelancë, paraqiti tekstin e rekomandimeve dhe i ftoi deputetët që t'i miratojnë ato.

Kryetari hodhi në votim rekomandimet e propozuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, njëzëri miratoi këto:

REKOMANDIME

1. Kuvendi i Kosovës i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës që në fushën e politikave sociale të ketë prioritet rinegocimin e Marrëveshjes për sigurimet shoqërore me Zvicrën;
2. Kuvendi i Kosovës i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës t'i procedojë me përparësi në Kuvendin e Kosovës ligjet e nevojshme që hapin rrugë për nënshkrimin e Marrëveshjes për sigurimet shoqërore ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës, Ligjin për sigurimet pensionale, Ligjin për sigurimin invalidor, Ligjin për sigurimet shëndetësore, përkatësisht përshtatjen e tyre, që e bën të mundur nënshkrimin e Marrëveshjes për sigurimet shoqërore Kosovë-Zvicër;
3. Në ligjet që miratohen në Kuvend e Kosovës dhe në aktet tjera nënligjore të ministrive përkatëse të parashihet eksportimi i mjeteve nga përfituesit e sigurimeve shoqërore;
4. Qeveria e Republikës së Kosovës të formojë Grupin punues ndërministror që merret me çështjet që kanë të bëjnë me koordinimin e aktiviteteve, që e bëjnë të mundur arritjen e Marrëveshjes Zvicër-Kosovë për sigurimet shoqërore;

5. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të japë gjithë garancitë e nevojshme për transparencë të plotë lidhur me përfituesit e sigurimeve shoqërore, që kanë qenë në Zvicër dhe që janë kthyer apo do të kthehen në Kosovë. Këtu hynë rregullimi i Regjistrimit civil dhe mekanizmave përkatës mbikëqyrës që pamundësojnë abuzimin me pensionet invalidore;
6. Të bëhet një takim i lartë qeveritar Kosovë – Zvicër lidhur me rinegociimin e Marrëveshjes për sigurimet shoqërore;
7. Të nënshkruhet Memorandum i mirëkuptim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës për zgjidhjen adekuate të përkohshme, deri në zgjidhjen e përhershme të kësaj çështjeje;
8. Qytetarët e Republikës së Kosovës, që jetojnë në Zvicër apo që janë në Kosovë, të njoftohen lidhur me këtë çështje, deri në nënshkrimin e Marrëveshjes së re, për të mos rënë pre e spekulantëve dhe agjencive që i dezinformojnë ata për qëllime të përfitimit.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për persona të zhdukur

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për persona të zhdukur

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** tha se nevoja për nxjerrjen e Projektligjit për persona të zhdukur konsiston në numrin shumë të madh të të zhdukurve nga lufta e vitit 1998-1999 në vendin tonë.

Në vazhdim, tha se ky projektligj ka për qëllim të mbrojë të drejtat e personave të zhdukur dhe të familjarëve të tyre, në veçanti të drejtën e familjarëve për të ditur për fatin e më të dashurve të tyre, të zhdukur në periudhën 1 janar 1998 – 31 dhjetor 2000, si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë në vitet 1998 -1999.

Më tej, ai tha se me këtë projektligj përcaktohen edhe kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, do të krijohet gjithashtu edhe Regjistri qeveritar për persona të zhdukur, ndërse të dhënat do të jenë në pajtim me Ligjin për qasje në dokumentet zyrtare.

Në fund, zëvendëskryeministri Kuçi ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj, në parim.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin e Projektligjit për persona të zhdukur.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Nerxhivane Dauti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Zylfije Hundozi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Drita Maliqi, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Shpresa Murati, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Driton Tali, Luljeta Shehu, Teuta Hadri, Njomza Emini, Bujar Dugolli, Bahri Hyseni, Ismajl Kurteshi, Riza Smaka, Naim Rustemi, Ahmet Isufi, Naser Rugova, Sanije Aliaj, Jakup Krasniqi dhe zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----63,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi pa asnjë votë kundër miratoi, në parim, Projektligjin për persona të zhdukur.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin prej dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për financimin e subjekteve politike

Kryesuesi njoftoi Kuvendin se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për financimin e subjekteve politike dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryesuesi i hodhi në votim një nga një amendamentet e komisionit funksional. Kuvendi miratoi amendamentet nr. 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 10, 12 A. 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23 të propozuar në Projektligjin për financimin e subjekteve politike.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi vendosi që fjala “ **të fituara**”, të fshihet në tërë tekstin e Ligjit dhe ajo të zëvendësohet me fjalën “ **në Kuvend**”.

Kryesuesi, në vazhdim hodhi në votim tekstin e Projektligjit për financimin e subjekteve politike, në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----56,
Kundër-----3,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për financimin e subjekteve politike.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës

Kryesuesi njoftoi Kuvendin se Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media e ka shqyrtuar Projektligjin për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Deputeti **Hajredin Hyseni**, në emër të komisionit funksional, tha se si komision kemi shqyrtuar dhe paraqitur amendamentet, për miratim, duke përkujtuar se me miratimin e këtij projektligji përmbushet një nga pikat e paraqitura në Raportin e progresit të Komisionit Evropian për Kosovën.

Ai ftoi deputetët të miratojnë këtë Projektligj.

Kryesuesi i hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara..

Kuvendi miratoi amendamentet nr. 1, 2, 3, 4, 6, 7, 9, 10, 12 A. 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31 dhe 32, të propozuar në Projektligjin për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi, në vazhdim hodhi në votim tekstin e Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----59,
Kundër-----0,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për konfliktet administrative

Kryesuesi njoftoi Kuvendin se Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media e ka shqyrtuar Projektligjin për konfliktet administrative dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Deputeti **Esat Brajshori**, në emër të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media kërkoi nga deputetët që të jenë më të përqendruar gjatë procesit të votimit të amendamenteve.

Komisioni funksional, amendamentet e propozuara nga deputeti Riza Smaka i ka shqyrtuar, por ato nuk i kemi miratuar sepse mendojmë se të njëjtat amendamente janë të përfshira në amendamentet e propozuara nga Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, tha ai.

Ai ftoi deputetët ta miratojnë këtë Projektligj.

Kryesuesi i hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara..

Kuvendi miratoi amendamentet nr. 1, 2, 3 (a), 4, 5, 6, 7, 8, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27 dhe 28.

Kryesuesi hodhi në votim tekstin e Projektligjit për konfliktet administrative në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----60,
Kundër-----0,
Abstenime-----6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për konfliktet administrative.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 15:18 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale